



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2195 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 383
Data/Datum/Date 26/5/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

NJOFTIM

Për mbajtjen e takimeve publike me qytetarë me banorë të fshatit **Hoçë e Madhe dhe takim publik me Rininë**

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komuna, kryetari i Komunës, Smajl Latifi organizon takime publike me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve në **Hoçë të Madhe dhe takim publik me Rininë**.

Duke e pasur parasysh përkushtimin për përmbushjen e kërkesave të qytetarëve, Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi përdor mekanizma të këshillimeve dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në takime, për vlerësimet dhe propozimet për çështje të interesit të tyre.

Duke qenë pjesë e këtyre takimeve, ftojmë qytetarët të japin kontributin e tyre!

Tema e takimeve: Kërkesat e tyre dhe ecuria e projekteve për vitin 2022.

Takimet mbahen në:

1	Hoçë e Madhe	Objekti "Shtëpia e Kulturës", fshati Hoçë e Madhe	6.6.2022	10:00
2	Takimi me Rininë	Objekti i Qendrës Rinore "SHL Kosova", Rahovec	6.6.2022	13:00

Jeni të mirëpritur!

